



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

K.Dh.Sh.II.nr.1422/23

GJYKATA KOMERCIALE – Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtari Dren Rogova, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Raiffeisen Bank Kosovë, me seli në Prishtinë, kundër debitorëve 1. D.P.H Prizren” / “Prizren O.P me seli në Pejë, rr. “Eliot Engel”, 2. A.L., me adresë në Pejë, dhe 3. M.L., me adresë në Pejë, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorëve të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1514/22 të datës 26.09.2023, me datën 03.06.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorëve D.P.H Prizren” / “Prizren O.P me seli në Pejë, rr. “Eliot Engel”, A.L. nga Peja dhe M.L., nga Peja, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP, nr.1514/22 i datës 26.09.2023, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1514/22 të datës 26.09.2023, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorëve 1. D.P.H Prizren” / “Prizren O.P me seli në Pejë, rr. “Eliot Engel”, 2. A.L., me adresë në Pejë, dhe 3. M.L., me adresë në Pejë, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.202/21 të datës 24.03.2021, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Gjokë Radi dhe ka lënë në fuqi Urdhrit Përmbartimor P.nr.202/21 të datës 24.03.2021, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Gjokë Radi.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor kanë paraqitur ankesë debitorët, për shkak të cënimeve qenësore të dispozitave të LPP-së, verifikimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që të priset aktvendimi i atakuar dhe të aprovet ankesa si e bazuar, apo çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Kreditori në përgjigje në ankesë i propozon gjykatës që ankesën e debitorëve ta refuzoj në tërësi si të pabazuar ndërsa aktvendimin e atakuar ta vërtetoj.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

- Ankesa e debitorëve është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori më datën 24.03.2021, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorëve, në bazë të Marrëveshjes mbi pengun e luajtshëm e datës 20.11.2015 e regjistruar në regjistrin e pengut sipas Konfirmimit mbi regjistrimit e pengut me R-2015121-95 e datës 11.12.2023, si dhe Kontratës mbi hipotekën LRP.nr. 6841/2015 e datës 20.11.2015, e regjistruar sipas aktvendimit mbi regjistrimin e hipotekës nr. 01-10/334 e datës 26.11.2015, për pagesën e borxhit të papaguar nga Marrëveshja mbi Kredinë nr.200698586 e datës 20.11.2015, për shumën e përgjithshme të borxhit në vlerë prej 34,418.06€.

Përmbartuesi privat Gjakë Radi, me seli të zyrës në Gjakovë, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.202/21 të datës 24.03.2021 me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm Marrëveshjen mbi pengun e luajtshëm e datës 20.11.2015 e regjistruar në regjistrin e pengut sipas Konfirmimit mbi regjistrimit e pengut me R-2015121-95 e datës 11.12.2023, si dhe Kontratës mbi hipotekën LRP.nr. 6841/2015 e datës 20.11.2015, e regjistruar sipas aktvendimit mbi regjistrimin e hipotekës nr. 01-10/334 e datës 26.11.2015, për pagesën e borxhit të papaguar nga Marrëveshja mbi Kredinë nr.200698586 e datës 20.11.2015.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbartimit, brenda afatit ligjor, prapësim kanë paraqitur debitorët në të cilin ka theksuar se kontratat në bazë të së cilave është lejuar përmbartimi nuk gjenden të listuara në asnjërën nga dispozitat e nenit 22 dhe nenit 29 të LPP-së, mirëpo në mënyrë ekskluzive e kanë përcaktuar që gjykata kompetente do të jetë kompetente e në asnjë rast përmbartuesi privat. Kontrata e lidhur mes debitorëve dhe kreditorit nuk mund të shërbej si dokument përmbartues sepse nuk është nxjerr konform nenit 21 të LPP-së, e po ashtu urdhri përmbartimor nuk i përmbush kushtet e parapara me nenin 43 par.4 të LPP-së. I propozon gjykatës që prapësimi i debitorëve të aprovohet ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet jashtë fuqie.

Në përgjigjen në prapësim kreditori kundërshton pretendimet e debitorit sepse propozimi për përmbartim i plotëson të gjitha kushtet nga neni 38 par.1 i LPP-së, ndërsa debitorët që nga rënia në vonesë për pagimin e kësteve të kredisë janë kontaktuar dhe takuar vazhdimisht nga zyrtarët e vonesave të kreditorit, mirëpo nuk kanë treguar gatishmëri për zgjidhje. I propozon gjykatës që prapësimi i debitorëve të refuzohet dhe urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1514/22 të datës 26.09.2023, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorëve 1. D.P.H Prizren” / “Prizren O.P me seli në Pejë, rr. “Eliot Engel”, 2. A.L., me adresë në Pejë, dhe 3. M.L., me adresë në Pejë, të ushtruar kundër Urdhrit për lejimin e përmbarimit numër P.nr.202/21 të datës 26.09.2023. Në arsyetim të aktvendimit gjykata e shkallës së parë, referohet ne dispozitat e nenit 21 dhe 22 të LPP-së. dhe dokumentet si: marrëveshja mbi pengun e luajtshëm dt.20.11.2015 dhe Kontratës mbi hipotekën LRP.nr.6841/2015 dt.20.11.2015.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore kur e ka refuzuar prapësimin e debitorëve të paraqitur kundër urdhrit të përmbaruesit privat, me të cilin është caktuar përmbarimi i propozuar nga kreditori. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se Gjykata duke vlerësuar Marrëveshjen mbi pengun e luajtshëm e datës 20.11.2015, si dhe Kontratës mbi hipotekën LRP.nr. 6841/2015 e datës 20.11.2015, gjeti se të njëjtat janë paraqitur në origjinal, janë hartuar në formën e paraparë me ligj, dhe të njëjtat janë regjistruar në regjistrat publik, fakt ky që vërtetohet nga Konfirmimi mbi regjistrimin e pengut me R-2015121-95 e datës 11.12.2023, respektivisht Aktvendimi mbi regjistrimin e hipotekës nr. 01-10/334 e datës 26.11.2015 dhe si të tilla përbëjnë bazë juridike për caktimin e përmbarimit, ngase i kanë plotësuar kushtet ligjore nga neni 22 par.1.7 a dhe neni 27 të LPP-së, për të qenë të përmbarueshëm dhe njëkohësisht të përshtatshëm për përmbarim.

Prandaj, bazuar ne këto arsye, Gjykata e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj te bazuar në dispozita konkrete ligjore, ashtu qe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Shkallës së Dytë. Sipas kësaj gjykate, aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe ne konstatim te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së dytë analizoi pretendimet e debitorëve me ankesë mirëpo gjeti se të njëjtat nuk janë të bazuara në ligj, për arsye se nuk ka ofruar prova në mbështetje të pretendimeve të tij siç është paraparë me nenin 69 par. 4 të LPP-së, se nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet ligjore për anulimin e Urdhrit të Përmbaruesit Privat apo shtyrjen e zbatimit të përmbarimit, të përcaktuara me dispozitat e nenit 61 par 1 pika 1 dhe neni 71 par 1, pika 1 deri në 12 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (Ligji nr. 04/L-139), të Republikës së Kosovës.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.Dh.Sh.II.nr.1422/23 me datë 03.06.2024

Gjyqtari  
Krenar Berisha